



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq./Br.str./No.pg 153

Data/Datum/Date 29 / 11 / 2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6, paragrafi 1, pika 1.1 dhe nenit 8, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë: 29.11.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

- 1. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/3339/23, i datës 07.11.2023 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
- 2. Pronat e paluajtshme** për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, janë:
 - 2.1. Parcela**, sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01057-2, në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur *skeja*, me kulturë Kullojë e klasës së 2-të, në sipërfaqe të përgjithshme prej 571m² (pesëqind e shtatëdhjetë e një metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit;
 - 2.2. Parcela**, sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01043-1, në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur *skeja*, me kulturë Kullojë e klasës së 3-të, në sipërfaqe prej 1000m² (një mijë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5016m² (pesë mijë e gjashtëmbëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
- 3. Qëllimi** i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe t'u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
- 4. Parcela e cekur** në pikën 1 të këtij propozimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 01 Nr. 2566, të datës 30.5.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
- 5. Afati kohor** për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh.
- 6. Prona e paluajtshme** në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**, sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.153/23
Me datë: 29.11.2023

